R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE SIGURISË PUBLIKE

Nr. 2710/1 prot. Tiranë, më 20.10.2026

Lënda: Dhënie mendimi mbi "*Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Islamike të Pakistanit në fushën e bashkëpunimit në luftën kundër trafikut të paligjshëm dhe abuzimit me narkotikët, substancat psikotrope, substancat e reja psikoaktive dhe prekursorët e tyre*"

MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit") ka administruar shkresën tuaj nr. 1538/4 prot., datë 24.09.2026, me anë të të cilës dërgoni për mendim "*Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Islamike të Pakistanit në fushën e bashkëpunimit në luftën kundër trafikut të paligjshëm dhe abuzimit me narkotikët, substancat psikotrope, substancat e reja psikoaktive dhe prekursorët e tyre*", si dhe relacionin shpjegues.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së saj, duke qenë se shtetet palë do të shkëmbejnë informacion, i cili mund të përmbajë edhe të dhëna personale, Zyra e Komisionerit sugjeron që në nenin 9 (Konfidencialiteti), pas pikës 9.3 ***të shtohet pika 9.4***, me këtë përmbajtje:

"9.4 Të dhënat personale të shkëmbyera në kuadër të kësaj marrëveshjeje do të përpunohen në përputhje me legjislacionet në fuqi për mbrojtjen e të dhënave, të shteteve palë. Çdo transferim i të dhënave personale do të kryhet vetëm në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale."

Me reflektimin e propozimit të mësipërm, Zyra e Komisionerit e vlerëson marrëveshjen të hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi